



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



02Nr 6342 /2022

09.08.2022

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68 , Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimin Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm **Komuna Hani Elezit** shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendeve të lira të punës)

Institucioni: **Komuna Hani Elezit**

Drejtoria: **Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

1.Titulli i vendit të punës: Motër edukatore

njësia/ sektori: IP “Ardhmëria”

Numri i pozitave: **Një (1) pozitë me afat të pacaktuar**

Koeficienti/Grada:A- 393/1

Orët e punës: **40 orë në javë**

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

Fakulteti i Edukimit – programi në fëmijërinë e hershme 0-3 vjeç;

Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi infermiere edukatore;

Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi i pediatriisë;

Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi mami;

Shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithshme.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimor dhe edukativ,
- Përdor metoda dhe teknika bashkohore të mësimdhënies duke marrë parasyshë
- nevojat individuale të nxënësve;
- Harton plane idividuale për nxënësit;
- Të edukojë fëmijën si një qenie të shoqërueshme të aftë, që të krijoj mardhënie me të
- tjerët;
- Mësimin e rregullave dhe bashkëpunimin në grup;
- Duhet të jenë të motivuara që të punojnë me fëmijë;
- Kryen punë tjera që i cakton drejtori i shkollë

2. Titulli i vendit të punës: Edukatore

njësia/ sektori: Shfmu “Ilaz Thaçi”

Numri i pozitave: **Një (1) pozitë me afat të caktuar**

Koeficienti/Grada: **A-393/1**

Orët e punës: **40 orë në javë**

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

Fakulteti i Edukimit – programi parashkollor;

Shkolla e Lartë Pedagogjike – drejtimi për edukatore;

Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë së përgjithshme;

Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimor dhe edukativ,
- Përdor metoda dhe teknika bashkohore të mësimdhënies duke marrë parasyshë
- nevojat individuale të nxënësve;
- Harton plane idividuale për nxënësit;
- Të edukojë fëmijën si një qenie të shoqërueshme të aftë, që të krijoj mardhënie me të
- tjerët;
- Mësimin e rregullave dhe bashkëpunimin në grup;
- Duhet të jenë të motivuara që të punojnë me fëmijë;
- Kryen punë tjera që i cakton drejtori i shkollës;

Dokumentet e nevojshme:

•Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)

•Rezumeja personale (CV).

•Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).

•Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jene kopje të noterizuara.

•Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)

•Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 08.09.2022 deri 22.09.2022 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirëpriten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> , në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.

Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

